



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1376 Prot.

Lezhë, më 28 . 01 . 2021

VENDIM

Nr 04 , Datë 27 / 01 / 2021

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR
NDIHMËN EKONOMIKE (FONDI 6 %) PËR VITIN 2021”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr . 597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të miratohen kriteret e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike si më poshtë:
 - a. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar muajin e fundit nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsye: Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
 - b. Për të gjitha familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas këtij fondi, duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social - ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2 të VKM nr.597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
 - c. Gjatë periudhës së trajtimit me fondin deri në 6 për qind, nëse verifikon që ka ndryshime të situatën social ekonomike, administratori shoqëror, referon familjen për të aplikuar në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike apo ndërpret periudhën e përfitimit në rast të punësimit të anëtarëve të familjes.

- d. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës ekonomike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI

ERNEST RAKAJ

